

VENDIM
Nr. 79, datë 14.2.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 28, DATË 17.1.2018, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT
TË MENAXHIMIT TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronjat “a”, “c”, “ç” dhe “dh”, të pikës 1, të vendimit nr. 28, datë 17.1.2018 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Z. Sokol Ismaili, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

c) Z. Ermal Elezi, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor;

ç) Z. Luigj Aleksi, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (riemërim);

dh) Z. Gëzim Beqaj, Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku